



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 13.01.2020, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Z. ARDIAN KOTORRI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Suharekë, nga subjekti politik "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - AAK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Shefket Kuçi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Ardian Kotorri dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 08.01.2020, Nr.03/2020, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z. Shefket Kuçi, pas dorëheqjes së tij të përvokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye dhe përkushtim ndaj profesionit të tij.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati i radhës në listën e rirenditur, i cila është, z. Ardian Kotorri, i cili e ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 13.01.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

